




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurençiju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 57/25 - 11/D  
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. 1/5  
Data/ Datum/ Date: 27. 01. 2025  
PRISHTINA - PRISTINA - PRISTINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurençiju - Competition Authority

Vendimi Nr. K-05/25  
Datë: 27.01.2025

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 27.01.2025, mori këtë;

### V E N D I M

**I. LEJOHET** përqendrim lidhur me krijimin e një shoqërie të re me përgjegjësi të kufizuar “Hyper Active Holding” si dhe transferimin e 40% të pronësisë që Fundway zotëron në Shoqërinë Target tek “Balfin”.

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përpunje me nenin 55, paragrafi 1.5, të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

### Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 18.12.2024, me Nr. Prot. 811/24-01/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me krijimin e një shoqërie të re me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me legjislacionin kosovar, të cilën do ta emërojnë “Hyper Aktive Holding”, ose sipas marrëveshjes ndërmjet palëve (tani e tutje referuar si “HoldCo” ose , si dhe “Hyper Aktive Holding”), si dhe transferimin e 40% të pronësisë që Fundway zotëron në Shoqërinë Target tek “Balfin”.

### Palët në Përqendrim:

**Fundway L.L.C.**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 810804395, me seli në rr. Perandori Justinian Nr.69, në Prishtine, e cila aktivitet primar ka menaxhimin e investimeve në sektor të ndryshëm si sigurime, zhvillim të softuerëve, argëtim, ndërtim, patundshmëri, shitblerje etj. Fundway zotëron 100% të ”Scardian Sigurime” kompani lidere në industrinë e sigurimeve. Së fundmi Fundway ka hyrë në dy

industri të ndryshme, por me një rol të madh në ekonominë e Kosovës. Në vitin 2021 Fundway ka nisur një sipërmarrje për të krijuar “HyperActive” një qendër e gjerë arkëtimi familjar. Në Kosovë, Fundway zotëron edhe shoqëritë e mëposhtme:

- “Unlimited Gaming” SH.P.K., NUI: 811860106
- “Scardian J.SC” SH.AS., NUI: 810838138
- “Fundway Motgages” L.L.C., NUI: 810804494

**Balfin- “Balkan Finance Investment Group” SH.P.K.**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar në pajtim me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri me numër të biznesit: (NUIS):K72223031K, Rr Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr.12, Kati 11, zyra nr. 1100, Njësia bashkiake nr.2, Tiranë, Shqipëri, njihet si një nder kompanitë liderë në fushën e investimeve në regjionin e Ballkanit Perëndimor. Balfin është pjese e një grupei të kompanive të ndryshme, i njojur si Balfin Group, që operon në sektorë të ndryshëm, si tregtia me shumicë dhe pakicë, logistika dhe sektori i energjisë.

Në Kosovë, Balfin Group ka tre (3) subjekte të regjistruara pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, me të dhënat, si në vijim:

- ELEKTRO-SERVIS KOSOVA SH.P.K. me NUI: 810841818;
- Kid Zone Kosova SH.P.K me NUI: 810839235;
- Neptun Kosova SH.P.K. me NUI: 810534207.

**Unlimited Gaming SHPK.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, me emër tregtar “Hyper Aktive” me numër të biznesit:811860106, dhe me adresë në qendrën tregtare Prishtina Mall, Graçanicë, e cila dhe ka ndërtuar ekspertizë profesionale në menaxhimin e parqeve argëtuese ( tani e tutje referuar si “Shoqëria Target”). Shoqëria target aktualisht zotërohet 100% nga Fundway L.L.C.

#### **Procedurat e ndjekura:**

- Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 10.01.2025
- Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 13.01.2025
- Me datë 30 Shtator 2024, Palët kanë nënshkruar marrveshjen fillestare, “Fundway” dhe “Balfin”.

#### **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- I. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- II. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.

## **Struktura e Përqendrimit:**

Përqendrimi do të realizohet përmes krijimit të ndërmarrjes së përbashkët nga Fundway dhe Balfin, të emëruar “HyperActive Holding” (targeti) si dhe transferimit të 40% të kapitalit aksionar të Shoqërisë Target, nga Fundway tek Balfini, përkësish Unlimited Gaming.

Rrjedhimisht, struktura ekonomike dhe financiare e këtij përqendrimi përbehet nga ndërmarijet si në vijim: Fundway dhe Balfin. Ky përqendrim mundëson zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, përfshirë menaxhimin e investimeve dhe operacioneve të parqeve argëtuese përmes transferimit të aksioneve të Shoqërisë Target.

## **Analiza e konkurrencës**

**Tregu i produktit - parqet e argëtimit, përfshirë tregun e Kosovës**

**Tregu gjeografik** - Sipas udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, tregu gjeografik do të thotë tregu që përfshinë zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftë homogjene dhe mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinje. Transaksion përkatësisht krijimi i ndermarrjes se perbashkët ka përfshirë tregun e Kosovës, atëherë tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet, Republika e Kosovës.

Nga analiza e të dhënavëve nga dokumentacioni, sipas “Njoftimit” tregu përkatës ka një numër të madh konkurrentësh të fortë dhe pjesa e tregut të ndërmarrjes së përbashkët nuk vërehet se do të ketë ndikim në konkurrencë. Nëse ndërmarrja e re përmirëson cilësinë e shërbimeve ose inovacionin në treg, kjo mund të kontribuojë pozitivisht për konsumatorët. Përqendrimi nuk shtrembëron konkurrencën efektive, as nuk krijon një pozicion dominues.. Prandaj, përqendrimi i synuar nuk është i ndaluar sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 08/L-056, përfshirë Mbrojtjen e Konkurrencës.

## **Efektit e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Arsyeja e kërkesës së njoftimit përfshirë përqendrimin është se pala njoftuese ofron shërbime të parqeve argëtuese në Republikën e Kosovës. Ky transaksion synon të krijoje një strukturë të përqendruar dhe të fuqizuar, duke sjell një koordinim më të lartë në menaxhimin e resurseve dhe investimeve të përbashkëta, ndërkohe që përdorimi i kontrollit të aksioneve në Shoqërinë Target nga “Balfin” i mundëson të njëjtit të ketë një ndikim më të madh në operacionet dhe strategjitet e kësaj shoqërie.

Përqendrimi do të realizohet përmes krijimit të ndërmarrjes së përbashkët nga Fundway dhe Balfin, te emëruar “HyperActive Holding” Palët parashikojnë se implementimi i përqendrimit nuk do të sjelle asnjë ndikim negative përfshirë konsumatorët në Kosovë. Përkundrazi, ky proces do të krijoj mundësi përfshirë zgjedhje më të shumta dhe do të mundësoj një qasje me fleksibilitet ndaj produkteve me cilësi më të larte dhe më inovative. Konsumatorët do të kenë qasje në oferta të reja, më të përmisura, që do të përfshirin kërkuesat e tyre në mënyre më efikase dhe me vlerë të shtuar. Vizitoret do të përfitojnë nga

një përzgjedje më e gjere e atraksioneve, pakove më të integruara argëtuese dhe potencialit për çmime më të mira përmes sistemeve të kombinuara të biletave, programeve të besnikërisë dhe shërbimeve të përbashkëta. Efikasiteti i përmisuar operacional do të lejoje çmime me konkurruese, duke i bere aktivitetet e kohës se lire më të përballueshme dhe të qasshme për një game më të gjere të konsumatorëve. Transaksi i propozuar nuk do të ndikoj në tregun e Republikës së Kosovës dhe si i tillë nuk ngrit shqetësimin për konkurrencën dhe as konsumatorët në Republikën e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës dhe tregu i Kosovës mbetet i pandikuar nga ky transaksion. Përqendrimi synon të permisoj cilësinë dhe shërbimet e ofruara duke përdorur fuqinë dhe njohurit e të dyja kompanive. Qëllimi është të modernizohen pajisjet dhe objektet, të krijojen atraksione me inovative dhe të ndryshme, si dhe të përmisohet standardi i përgjithshëm. Konkurrent kryesor të ketije përqendrimi janë qendrat familjare të argëtimit në Kosove si: Blissville, Vitaland, Grand Store Playground, Royal Mall Playgraund dhe Albi Mall Playgraund. Prania e shume konkurrenteve ne tregun e industrisë se paraqve te argëtimit ne Kosove krijon një mjeshtë konkurrues te shëndetshëm dhe përqendrimi i propozuar do të ketë vetëm ndikime pozitive, duke sjell një game më të gjere mundësish për konsumatorët, përmisim të inovacionit dhe çmime konkurruese.

Autoriteti, me marrjen e njoftimit të plotë të përqendrimit, në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 në paragrafi 3.4, ka publikuar në ueb faqen e vet njoftimin publik, për përqendrimin e synuar, i cili është obliguar të qëndroj 15 ditë, (<https://ak.rks-gov.net>), lidhur me parashtrimin e vërejtjeve, komenteve, në mënyrë që të dhënat e mbledhura të kontribuojnë në sqarimin, pra në kuptim, të marrëdhënies dhe situatës në tregjet përkatëse. Autoriteti, nuk ka pranuar asnjë reagim, nga palët e interesuara.

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr.08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, llojet e Përqendrimit që kapen nga rregullat e kontrollit të bashkimit janë ato që plotësojnë dy kushte: transaksi duhet të përbej një Përqendrim sipas kuptimit të nenit 11 të ligjit të konkurrencës dhe duhet të plotësohet pragu i qarkullimit të parashikuar në nenin 13 të ligjit të konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës, ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

**Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkuruese, do të jetë, nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI**



Neime Binaku-Isufi

Kryetare

Nafije Osdautaj

Anëtare

Kaltrina Sela  
Nënkyrytare

Salihe Gashi Loku  
Anëtare

**III. Me këtë Vendim, të njoftohen:**

- Palët
- Arkiva